REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Mbrojtjes
Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

# U R D H Ë R

Nr.3886 datë 02.10.2019

## PËR
## "PLOTËSIMIN E FORMULARIT BASHKËNGJITUR PËR DORËZIMIN E KËRKESAVE/DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM NGA ANA E SUBJEKTEVE"

Në zbatim të Ligjit Nr. 46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", si dhe të pikës 2, të Kreut IV, të VKM nr. 43, datë 16.01.2008 "Për organizimin funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve", si dhe Rregullores së AKSHE-së nr. 2834, datë 16.10.2019 me qëllim caktimin e një praktike tip e cila do të lehtësojë procedurën e dorëzimit të kërkesave / dokumentacionit për pajisje me çertifikata / licensa / autorizime / të tjera, nga ana e subjekteve aplikuese pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve:

## URDHËROJ

1. Plotësimin e "Formularit për të dhënat e kontaktit", formular i cili do ti bashkëlidhet kërkesës për aplikim të subjektit aplikues në momentin e dorëzimit të dosjes së dokumentacionit pranë AKSHE.

2. Dokumentacioni i paraqitur, duhet të jetë i listuar dhe numërtuar nëpërmjet një liste dokumentesh, vendosur në krye të dosjes.

3. Subjekti në momentin e paraqitjes së kërkesës për aplikim dhe dorëzimit të dokumentacionit, pranë Sekretarisë së Institucionit, ku Sekretari nëse vëren se kërkesa nuk është shoqëruar me Formularin për të dhënat e kontaktit, si dhe listën e numërtuar të dokumenteve në krye, ka të drejtë të vendosë kthimin e akteve subjektit aplikues.

4. Subjektet e interesuara për të marrë informacione të mëtejshme do të priten nga një person i caktuar, punonjës i AKSHE-së, në ambjentin e pritjes, si dhe do të ndalohet rreptësisht qarkullimi i personave të jashtëm ta paautorizuar, në ambjentet e AKSHE -së.

5. Urdhërohen punonjësit e caktuar për pranimin e kërkesave për aplikim dhe pritje, për zbatimin e këtij Urdhri.

6. Ky urdhër së bashku me Formularin për të dhënat e kontaktit do të publikohet në faqen zyrtare të AKSHE-së www.akshe.gov.al

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Engjëllush BEKTESHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE – MINISTRIA E MBROJTJES

# FORMULAR PËR TË DHËNAT E KONTAKTIT

## Për të siguruar njoftimin e aplikuesit dhe personave qe e perfaqesojne

**Ju lutemi shkruani me shkronjë të madhe dhe një shkronjë apo numër për kuti. Plotësuesi mban përgjegjësi për të dhënat e shënuara.**

*Plotësohet nga AKSHE*
Nr. i prot: ______________________
Data e dorzimit: ______________________

Autoriteti i Kontrollit Shteteror te Eksporteve
Data(psh.01|12|2013)______________________

**(Shënoni për cilin janë këto të dhëna, psh. Aplikuesin, perfaqesuesin ligjor, etj.)**

**TË DHËNA PËR:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **EMRI:** | | | |
| **MBIEMRI:** | | | |
| **ATËSIA:** | | | |
| **NR.I KARTËS SË IDENTITETIT:** | | | |
| **DATËLINDJA:** | | **VENDLINDJA:** | |
| **CEL** | | Ose | |
| **E-MAIL**(plotësojeni nëse e keni në përdorim): | | | |

**ADRESA KRYESORE E KONTAKTIT:(Kjo do të përdoret nga AKSHE për dorëzimin e njoftimeve për apikiminin.)**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri(nëse është i ndryshëm nga më sipër) ose Personi fizik/ juridik | | | | | |
| Rruga / Lagjja: | | | | | |
| Ndërtesa / Pallati: | | Hyrja: | | Kati: | Ap: |
| Qyteti / Komuna: | | | | Kodi postar: | |
| Rrethi: | | Sqarimeshtesë për adresën (psh: Pranë Bashkisë): | | | |
| Tel.fiks: | | | | | |

**ADRESA E VENDBANIMIT APO E PUNËS:**(Plotësojenivetëm nëse është e ndryshme nga mësipër.)

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Rruga / Lagjja: | | | | | |
| Ndërtesa / Pallati: | | Hyrja: | | Kati: | Ap: |
| Qyteti / Komuna: | | | | Kodi postar: | |
| Rrethi: | | Sqarime shtesë për adresën (psh: Pranë Bashkisë): | | | |
| Tel.fiks: | | | | | |

**PLOTËSUESI:Jap pëlqimin që të kontaktohem nga AKSHE në kontaktet elektronike (telefon; celular; e-mail) të dhëna nga unë si mësipër.**

| | | |
|---|---|---|
| CILËSIA | EMRI MBIEMRI | Firma |